

TIMSS (Trends in International Mathematics and Science Study) është studim ndërkombëtar për matematikë dhe për një grup të lëndëve natyrore (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi) i cili bën matjen e njohurive dhe aftësive të nxënësve në matematikë dhe në grupin e lëndëve natyrore (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi) në klasën IV dhe VIII. Organizata ndërkombëtare për vlerësimin e arritjeve arsimore (International Association for the Educational Achievement - IEA) e udhëheq organizimin dhe realizimin e këtij studimi. Republika e Maqedonisë, përmes Qendrës shtetërore të provimeve deri më tani ka marrë pjesë në tre cikle: TIMSS 1999, TIMSS 2003 dhe TIMSS 2011 kryesisht me nxënësit e klasës VIII.

Në periudhën prill - maj 2019 do të realizohet testimi kryesor nga që do të vijojë një raport gjithëpërfshirës. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga testimi kryesor do të bëhet edhe një analizë krahasuese e rezultateve të vendeve pjesëmarrëse në raport me mesataren internacionale, përkatësisht vendi jonë do të radhitet me vendet tjera pjesëmarrëse në studim. Përmes pyetësorëve për nxënës, mësimdhënësit, prindër, drejtorë dhe bashkërenduesit nacional fitohen të dhënat për atë se si klima dhe kultura në shkollë, përvoja mësimore, qëllimet e programeve mësimore, kushtet socio-ekonomike të nxënësve dhe shkollat, rregullimi sistematik i arsimit dhe të tjera ndikojnë në të arriturat e nxënësve.

Byroja e zhvillimit të arsimit përfshihet në periudhën e përgatitjes për realizimin e testimit, me punë profesionale dhe këshilldhënëse me mësimdhënësit për vetë procesin e testimit si dhe me dhënien e udhëzimeve, ndihmës dhe përkrahjes në planifikimin dhe realizimin e detyrave përkatëse me nxënësit në përputhje me kërkesat e testimit ndërkombëtar.